



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr.....prot. 3609/1

Date 07/06 2023

URDHËR

Nr. 287, datë 07/06 2023

PËR

“SHPALLJEN E THIRRJES PËR FINANCIMIN E IAL-VE PUBLIKE, PËR PROJEKTE TË PËRBASHKËTA NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 110, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” si dhe Vendimit nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për IAL-të publike, nga fondet e miratuara për vitin 2023, në programin e “Arsimit të lartë” (09450).
2. Drejtimi i thirrjes për financimin e projektit/projekteve të paraqitura është si më poshtë:
 - a) Zhvillimi, përmirësimi apo rritja e infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore të IAL-ve publike, në kuadër të marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e vendeve të BE-së dhe të tjerë, për të tre ciklet e studimit. Në këtë drejtim përfshihen projektet për investime kapitale të cilat kanë si qëllim zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të reja apo atyre ekzistuese akademike, didaktike-mësimore dhe laboratorike, në funksion të realizimit të programeve të përbashkëta të studimit.
 - b) Në rastet kur projekti i aplikuar përfshin edhe zëra apo aktivitete që lidhen me zhvillimin, përmirësimin dhe përafrimin e kapaciteteve akademike të mësimdhënies, apo pagesa për shpenzime korrente, shpenzimet për këto zëra do të mbulohen nga fondet e miratuara për IAL-të në fillim të vitit 2023 “grandi i mësimdhënies” ose nga

të “ardhurat e veta” të IAL-së, në varësi të strukturës së shpenzimeve të projekt-propozimit të paraqitur nga IAL-të publike.

3. Vlera totale për financimin e aplikimeve të paraqitura sipas drejtimit të thirrjes është 300.000.000 (treqind milion) lekë, nga të cilat, fondet për vitin 2023 janë 114.800.000 (njëqind e katërbëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë.
4. Cikli i financimit të projektit parashikohet në 2 (dy) vite buxhetore, përkatësisht viti 2023 dhe viti 2024.
5. Përparësi në përzgjedhjen e projekteve fitues do të kenë institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkëta me institucione të huaja dhe të cilat deklarojnë përqindje (%) më të lartë të bashkëfinancimit nga të ardhurat e tyre për projekt-propozimin e paraqitur.
6. Aplikuesit, përveç kërkesës për financim, duhet të bashkëlidhin në aplikim edhe projekt-propozimin, ku të identifikohen qartësisht objektivat, aktivitetet, kostot e parashikuara dhe masa e bashkëfinancimit. Aplikimit duhet ti bashkëlidhet edhe konfirmimi i Bordit të Administrimit për disponueshmërinë e fondeve, kur parashikohet financim nga IAL-ja sipas përcaktimve të gërmes b) të pikës 2 të këtij urdhëri.
7. Aplikimi për financimin e projekteve bëhet nga IAL-të publike, brenda datës 20 Qershor 2023.
8. Vlerësimi i projekteve kryhet brenda datës 30 Qershor 2023.
9. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, drejtorja e buxhetit dhe menaxhimit financiar për njoftimin e IAL-ve publike si dhe publikimin e urdhrin në website-in e ministrisë së arsimit dhe sportit dhe agjencinë e Prokurimit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

EVIS KUSHI
MINISTËR

